



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.2382/12 prot.

Datë 05.01.2024

V E N D I M
Nr. 10/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 05.01.2024, mori në shqyrtim çështjen me,

Objekt: Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 1296/2023, datë 14.12.2023 për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-80785-09-21-2023, Loti 2: me objekt: “Poltrone aparatura etj per punktin e kemioterapise”, me fond limit 7,392,333 lekë, parashikuar për tu zhvilluar në datën 09.10.2023 nga autoriteti kontraktor Spitali Fier.

Ankimues: Operatori ekonomik “BIOMETRIC ALBANIA” SHPK, me
NIPT: J61827062E
Adresa: Bulevardi “Zhan D’Ark”, Pallati Nr. 53, Ap. 6B, Tiranë

Autoriteti Kontraktor: Spitali Fier
Adresa: Lagja “1Maj” Rruga “Invalidet e Luftes”, Fier

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr.766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datë 14.12.2023, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr.1296/2023, ku vendosi:

- 1. Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “BIOMETRIC ALBANIA” SHPK, për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-80785-09-21-2023, Loti 2: me objekt: “Poltrone aparatura etj per punktin e kemioterapise”, me fond limit 7,392,333 lekë, parashikuar për tu zhvilluar në datën 09.10.2023 nga autoriteti kontraktor Spitali Fier.*
- 2. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “BIOMETRIC ALBANIA” SHPK, për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-80785-09-21-2023, Loti 2: me objekt: “Poltrone aparatura etj per punktin e kemioterapise”, me fond limit 7,392,333 lekë, parashikuar për tu zhvilluar në datën 09.10.2023 nga autoriteti kontraktor Spitali Fier.*
- 3. Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet përkatëse në përputhje me arsyetimet dhe konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe të publikojë të gjitha ndryshimet në Sistemin Elektronik të Prokurimeve.*
- 4. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.*
- 5. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “BIOMETRIC ALBANIA” SHPK.*
- 6. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, Tiranë.*
- 7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Me shkresën nr. 4394 prot., datë 26.12.2023, protokolluar me tonën nr. 2382/9 prot., datë 29.12.2023, autoriteti kontraktor, njofton se ka zbatuar vendimin nr. 1296/2023, datë 14.12.2023, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-80785-09-21-2023, Loti 2: me objekt: “Poltrone aparatura etj per punktin e kemioterapise”, me fond limit 7,392,333 lekë, parashikuar për tu zhvilluar në datën 09.10.2023 nga autoriteti kontraktor Spitali Fier.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton

II.1 Me shkresën nr. 4394 prot., datë 26.12.2023, protokolluar me tonën nr. 2382/9 prot., datë 29.12.2023, autoriteti kontraktor, njofton se ka zbatuar vendimin nr. 1296/2023, datë 14.12.2023,

të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr. REF-80785-09-21-2023, Loti 2: me objekt: “*Poltrone aparatura etj per punktin e kemioterapise*”, me fond limit 7,392,333 lekë, parashikuar për tu zhvilluar në datën 09.10.2023 nga autoriteti kontraktor Spitali Fier.

II.2. Referuar shkresës së mësipërme, të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe verifikimeve të kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, konstatohet, se autoriteti kontraktor ka modifikuar dokumentat e tenderit, dhe ka publikuar shtojcën për modifikimin e dokumenteve të tenderit të procedurës së mësipërme të prokurimit, e cila është në përputhje me vendimin nr. 1296/2023, datë 14.12.2023 të Komisionit të Prokurimit Publik.

II.3. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se autoriteti kontraktor Spitali Fier ka zbatuar vendimin Nr. 1296/2023, datë 14.12.2023, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi.

Përsa më sipër, mbështetur në nenet 30, 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenin 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr. REF-80785-09-21-2023, Loti 2: me objekt: “*Poltrone aparatura etj per punktin e kemioterapise*”, me fond limit 7,392,333 lekë, parashikuar për tu zhvilluar në datën 09.10.2023 nga autoriteti kontraktor Spitali Fier.
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Kryetar
Jonaid Myzyri

